



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 121/2013
Prishtinë, më 11.10.2013, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, zëvendëskryetare, Sala Berisha–Shala, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Myzejene Selmani dhe Etem Arifi.

Munguan: Zenun Pajaziti, Fikrim Damka, Visar Ymeri dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të ftuar: Fidaim Sahiti- MZHE dhe Naser Peci nga Fakulteti i Gjeoshkencave.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi–ZPRK, Burim Ejupi –INDEP dhe Flutura Gashi- Rrokum TV.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Teuta Sahatqija, zëvendëskryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 1.10.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit të Grupit të Punës për Nismën legislative “Projektligji për Shërbimin Gjeologjik”;
4. Te ndryshme.

Kryesuesja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas pikave të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 1.9.2013

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 1.9.2013, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Grupit të Punës për Nismën legjislative “Projektligji për Shërbimin Gjeologjik;

Kryesuesja, tha se në këtë pikë të rendit të ditës, do ta shqyrtojmë raportin e Grupit të Punës për Nismën legjislative, për Projektligjin për Shërbimin Gjeologjik. Ajo, theksoi se kryesuese e grupit të punës është znj. Sala Berisha- Shala, të cilës më pas ia dha fjalën për ta paraqitur raportin e grupit të punës.

Sala Berisha –Shala, fillimisht e falënderoi Komisionin që ka mbështetur nismën për hartimin e këtij projektligji dhe të gjitha palët që kanë marrë pjese në grupin punues gjatë hartimit të projektligjit në fjalë. Ajo theksoi se grupi punues, në bashkëpunim me organizatën INDEP-it, që po e mbështet punën e Komisionit, ka organizuar një punëtori dyditore, ku kanë qenë pjesëmarrës të gjithë aktorët, që kanë të bëjnë me këtë fushë, siç janë përfaqësuesit nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, nga Agjencia Gjeologjike e Kosovës dhe Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale si dhe eksperti i angazhuar prof. dr. Naser Peci. Projektligji në fjalë, tani është vetëm në formë të draftit dhe gjatë punës në grupin punues, janë hartuar 16 nene, pasi që ky Projektligj duhet të kalojë nëpër disa procedura, të dërgohet Kryesisë së Kuvendit pastaj Kryesia e procedon për Qeveri, pastaj Qeveria pasi ta shqyrton në afatin njëmuor, përsëri e kthen në Kuvend dhe projektligji mandej i nënshtrohet procedimit sikurse të gjithë projektligjet tjera. Ajo kërkoi të procedohet Projektligji për shërbimin gjeologjik për procedura të mëtutjeshme, pasi që kur të vjen për amendamentim mund të shqyrtojmë më hollësisht.

Myzejene Selmani, kërkoi nga kryesuesja që mos të shkohet më diskutime nen për nen por të sqarohet në vija të përgjithshme Projektligji për shërbimin gjeologjik.

Shaip Muja, tha që ka qenë pjesë e grupit punues dhe sqarimet që janë dhënë nga eksperti i kësaj fushe, z.Naser Peci janë të mjaftueshme dhe s’kemi nevojë të hyjmë në diskutime nen për nen dhe u pajtua që të procedohet Projektligji për shërbimet gjeologjike, për procedura të mëtutjeshme.

Sala Berisha-Shala - Propozoi që arsyeshmërinë dhe qëllimin e Projektligjit ta paraqet z. Naser Peci, profesori i Fakultetit të Gjeologjisë, që është i angazhuar nga komisioni si ekspert.

Naser Peci – tha se Shërbimi Gjeologjik luan rol të madh në tërheqjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta në sektorin e burimeve natyrore të Kosovës si dhe në plotësimin e nevojave të vendit për: resurset minerale, cilësinë dhe kontrollin e ujit, analizën e gjeorreziqeve, kërkesat e Qeverisë për gjeoinformacionet, arsimimin, industrinë, etj. Sidoqoftë, investuesit potencialë kërkojnë një burim të besueshëm të informatave, ekspertizë dhe të dhëna relevante gjeoshkencore për Kosovën dhe ky është roli kryesor për Shërbimin e ri Gjeologjik. Shërbimi Gjeologjik do të duhej të jetë si Agjenci e Pavarur e Kosovës, e përbërë nga stafi gjeoshkencor kosovar, të cilët kanë aftësi të mjaftueshme dhe kompetenca për të përmbushur normat në

përputhshmëri me Shërbimet Gjeologjike relevante Evropiane. Ndër prioritetet e para të Shërbimit Gjeologjik, janë ndërtimi i kapaciteteve të stafit, përvetësimi i të dhënave kryesore gjeologjike, gjeokimike, gjeofizike, hidrologjike, hidrogeologjike, resurseve minerale, përcaktimi i kushteve gjeologjike dhe prodhimi i bazave gjeologjike komplekse për nevoja të planifikimit, projektimit, ndërtimit të objekteve si dhe menaxhimi i informatave për sistemin informativ gjeoshkencor. Pra, misioni i një Shërbimi Gjeologjik është: “për të ofruar këshilla të paanshme gjeoshkencore dhe cilësore, informata për partnerë të shumtë, ku përfshihen Qeveria, opinioni publik dhe industria”. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, në të kaluarën ka luajtur edhe rolin e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës. Shumë projekte që janë zhvilluar atje janë projekte që i takojnë shërbimeve gjeologjike si: përpilimi i gjeohartave të Kosovës, me shkallë 1:200 000 dhe 1:100 000, matjet gjeofizike nga ajri, matjet gjeokimike nga lumenjtë, Plani i Guroreve të Kosovës, ka filluar përpilimi i planshetave 1:25 000. Komisioni tashmë ka themeluar një sistem të GIS, të avancuar dhe një metodologji të mbledhjes së të dhënave, e cila do të mund të adaptohej shpejt, lehtë dhe lirë në Shërbimin e ri Gjeologjik. Mendoj se kjo duhet të përfshihet në ligj sepse një pjesë e këtij arkivi ndodhet në KPMM dhe një pjesë në Arkivin e Kosovës (Arkivi gjeologjik nga ish- Enti për Hulumtime Gjeologjike). Grumbullimi i gjithë arkivit gjeologjik në kuadër të SHGJK-së, do të mundësonte mbledhjen, përgatitjen, valorizimin, përpunimin dhe shpërndarjen e të gjithave llojeve të informatave gjeologjike. Gjeolaboratori është projekt shumë i rëndësishëm i zhvillimit të punëve kërkimore. Organizimi i funksionimit të tij, kërkon një qasje shumëdimensionale, prandaj këtu duhet të përfshihen edhe institucione tjera, sidomos Fakulteti i Gjeoshkencave. Organizimi i tillë do të kishte dobi të shumëfishtë: avancimi i punëve kërkimore nga Shërbimi gjeologjik, avancimi i mësimdhënies dhe aftësisë të studentëve, që do të punojnë në sektorin e Gjeoshkencave si dhe puna për palë të treta. Prandaj, të gjitha këto informacione e forcojnë arsyeshmërinë që të përpilohet dhe të hyjë në fuqi Ligji për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, në mënyrë që ky shërbim të ketë bazën ligjore për kryerjen e misionit të tij.

Kryesuesja, pasiqë nuk pati deputetë të lajmëruar për diskutim, kërkoi nga administrata që të bëjë rregullimin edhe tekniko juridik, aty ku ka nevojë, para se projektligji të procedohet tutje.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. *Miratohet Raporti i Grupit të Punës për Nismën legislative “Projektligji për Shërbimin Gjeologjik”;*
2. *Raporti t’i procedohet Kryesisë së Kuvendit sipas procedurës.*

4. Të ndryshme. Çështjet vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zëvendëskryetarja e Komisionit,

Teuta Sahatqija